

## RELACION SHPJEGUES

### PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE AKSESIN NË REGJISTRIN ELEKTRONIK PËR KUJDESIN ALTERNATIV NË FAMILJE"

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Regjistri Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje përbën një instrument të ri institucional dhe teknologjik në sistemin shqiptar të mbrojtjes së fëmijëve, përmes të cilit garantohej menaxhimi i unifikuar, i gjurmueshëm dhe i sigurt i të gjitha rasteve të kujdestarisë alternative në familje. Ligji nr. 92/2025 "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë", me qëllim përcaktimin e rregullave për funksionimin e këtij regjistri, ka ngarkuar Këshillin e Ministrave me detyrimin e miratimit të një vendimi për këtë qëllim.

Krijimi i Regjistrit Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje është konceptualisht në linjë me procesin më të gjerë të digjitalizimit të shërbimeve sociale në Republikën e Shqipërisë, proces tashmë i nisur përmes Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, por e plotëson atë me një dimension të ri analitik dhe operacional: menaxhimin e integruar të rastit individual të fëmijës në kujdes alternativ në familje, që ndjek të gjithë ciklin nga referimi e deri te përfundimi i masës.

Projektvendimi ka si qëllim rregullimin e organizimit, funksionimit, administrimit dhe aksesit në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje, si dhe të përpunimit, mbrojtjes dhe përdorimit të të dhënave që përmban ky regjistër, në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 92/2025 "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë". Për këtë qëllim, projektvendimi përcakton strukturën, përmbajtjen, nivelet e aksesit dhe procedurat operacionale që do të ndjekë çdo aktor institucional gjatë përdorimit të regjistrit.

Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet:

- garantimi i një sistemi të unifikuar për identifikimin, referimin, menaxhimin dhe monitorimin e rasteve të fëmijëve në kujdes alternativ në familje, duke evituar fragmentimin dhe dyfishimin e të dhënave;
- mbështetja e vendimmarrjes institucionale dhe gjyqësore në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, përmes informacionit të plotë, të saktë dhe të përditësuar;
- sigurimi i gjurmueshmërisë së plotë të çdo mase të marrë për kujdesin alternativ, duke garantuar llogaridhënien e të gjithë aktorëve të përfshirë;
- përmirësimi i planifikimit dhe monitorimit të politikave dhe shërbimeve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, përmes statistikave të harmonizuara dhe analizave të bazuara në të dhëna reale;

- lehtësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional midis aktorëve të nivelit qendror, rajonal dhe vendor;
- forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e rasteve, përmes përdorimit të mjeteve digjitale të integruara.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektvendim është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2026, në kuadër të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të Ligjit nr. 92/2025.

Projektvendimi propozohet në funksion të zbatimit të drejtpërdrejtë të Ligjit nr. 92/2025 "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë", konkretisht në zbatim të nenit 13, pika 4, të këtij ligji, që përcakton detyrimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullave për organizimin, funksionimin dhe aksesin në Regjistrin Elektronik.

Projektvendimi mbështet zbatimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe është i harmonizuar me:

- angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara, përfshirë Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF), Konventën Europiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijës të Këshillit të Evropës, dhe Udhëzimet e OKB-së për Kujdesin Alternativ ndaj Fëmijëve (Rezoluta A/RES/64/142, 2009);
- detyrimet e procesit të integrimit europian, veçanërisht në kuadër të Kapitullit 19 të acquis-it për Politikën Sociale dhe Punësimin dhe Kapitullit 23 për Gjyqësorin dhe të Drejtat Themelore;
- Agjendën Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës 2021–2026, miratuar me VKM Nr. 659, datë 3.11.2021, e cila parashikon konsolidimin e sistemit digjital të menaxhimit të rasteve dhe deinstitutionalizimin progresiv të kujdesit për fëmijët;
- Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030, miratuar me VKM Nr. 152, datë 13.3.2024, që vendos digjitalizimin si shtyllë të reformës së shërbimeve sociale;
- Agjendën Digjitale të Shqipërisë 2022-2026, miratuar me VKM Nr.370, datë 1.6.2022, e cila parashikon ndërveprueshmërinë e plotë të bazave të të dhënave shtetërore dhe ofrimin e shërbimeve elektronike përmes platformës e-Albania.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Miratimi i projektvendimit është i nevojshëm për të garantuar që çdo rast i fëmijës në kujdes alternativ në familje të menaxhohet përmes një sistemi të vetëm, të integruar dhe

të gjurmueshëm, duke i dhënë fund praktikave të deritanishme të menaxhimit të fragmentuar, kryesisht në letër dhe pa standardizim midis institucioneve dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore. Për këtë qëllim, projektvendimi përcakton përbërësit kryesorë funksionalë të Regjistrit, duke përfshirë:

- arkitekturën institucionale të regjistrit dhe lidhjen e tij me Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror;
- strukturën modulare të të dhënave, që mbulon të gjithë ciklin e jetës së rastit;
- përgjegjësitë e qarta institucionale për hedhjen dhe përditësimin e të dhënave;
- ndërlidhjen me sistemet e tjera shtetërore për shkëmbim të të dhënave dhe verifikim të integruar;
- nivelet diferenciale të aksesit sipas rolit institucional;
- mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve dhe familjeve kujdestare.

Efektet e pritshme nga miratimi i projektvendimit janë pozitive dhe substanciale, pasi krijohet një kuadër rregullator që mundëson:

- përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes institucionale, duke siguruar që çdo vendim për kujdes alternativ të bazohet në informacion të plotë, të përditësuar dhe të verifikuar;
- garantimin e mbrojtjes së fëmijëve përmes monitorimit sistematik të çdo rasti dhe identifikimit në kohë të nevojave ose rreziqeve të reja;
- rritjen e gjurmueshmërisë dhe transparencës institucionale, duke parashikuar regjistrimin e çdo veprimi të kryer në sistem;
- forcimin e koherencës ndër-institucionale midis njësisve të vetëqeverisjes vendore, Shërbimit Social Shtetëror, gjykatave, dhe institucioneve të tjera të përfshira në mbrojtjen e fëmijës;
- mbështetjen e proceseve të deinstitutionalizimit dhe riintegritimit familjar, përmes të dhënave të disponueshme në kohë reale për përfitimet, planet individuale dhe ecurinë e rasteve;
- uljen e ngarkesës administrative mbi punonjësit socialë në nivel vendor, përmes automatizimit të proceseve të raportimit dhe ndërlidhjes me regjistra të tjerë.

Për të siguruar zbatimin efektiv të këtyre objektivave, projektvendimi përcakton qartë:

- organizimin institucional të regjistrit dhe rolin e Shërbimit Social Shtetëror si institucion administrues;
- strukturën modulare me të dhëna për referimin, familjet kujdestare, fëmijët e vendosur, vendimet administrative dhe gjyqësore, planet individuale, raportet e monitorimit dhe mbështetjen financiare;
- detyrimet e hedhjes dhe përditësimit të të dhënave brenda afatit prej 7 ditësh pune nga miratimi i tyre;
- ndërlidhjen me sistemet e tjera shtetërore përmes platformës e-Albania, duke përfshirë Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, ISSH, DPT dhe QKB;
- përgjegjësitë e qarta të të gjithë aktorëve institucionalë në proceset e punës;
- nivelet diferenciale të aksesit sipas rolit funksional të secilit aktor;

- mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve dhe familjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- detyrimet e raportimit periodik statistikor dhe analitik;
- mekanizmat e kontrollit dhe auditimit periodik të sistemit.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; dhe nenit 13, pika 4, të Ligjit nr. 92/2025 "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë". Projektakti është në përputhje të plotë me parimet kushtetuese të mbrojtjes së veçantë të fëmijëve (neni 54 i Kushtetutës), të barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 18), dhe të mbrojtjes së jetës private (neni 35), dhe synon zbatimin e parimit themelor të interesit më të lartë të fëmijës të sanksionuar në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.

Projektvendimi është gjithashtu në harmoni me legjislacionin e brendshëm përkatës, përfshirë:

- Ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";
- Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i korrigjuar;
- Ligjin nr. 10325/2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara";
- Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 9000/2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave".

Në planin ndërkombëtar, projektvendimi mbështet zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 7531/1991; Konventës Europiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijës (Strasburg, 1996); Udhëzimeve të OKB-së për Kujdesin Alternativ ndaj Fëmijëve (Rezoluta A/RES/64/142 e Asamblesë së Përgjithshme, 2009); Rekomandimit Rec (2005)5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës "Për të drejtat e fëmijëve që jetojnë në institucione të kujdesit rezidencial", Konventës së Hagës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në Çështjet e Birësimit Ndërkombëtar; Strategjisë së Këshillit të Europës për të Drejtat e Fëmijës 2022-2027; Objektivate të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 të OKB-së, veçanërisht Objektivit 16.2 për ndalimin e abuzimit, shfrytëzimit dhe dhunës ndaj fëmijëve.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE**

Projektvendimi në vetvete nuk synon përafrim të drejtpërdrejtë me një akt specifik të *acquis-it* të Bashkimit Europian, por kontribuon në mënyrë substanciale në forcimin e standardeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe të digjitalizimit të shërbimeve sociale në Republikën e Shqipërisë. Ai mbështetet në bindjen se një sistem i unifikuar dhe i integruar regjistrimi e bën efektivin zbatimin e parimeve të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, të harmonizuara me kërkesat e *acquis-it* të BE-së dhe me detyrimet e tjera ndërkombëtare.

Përkatësisht, projektvendimi kontribuon në zbatimin e:

- Strategjisë së Këshillit të Evropës-së për të Drejtat e Fëmijës (2022–2027) dhe vazhdimësisë së saj, që vendos aksesin në teknologji si prioritet horizontal;
- Strategjisë së BE-së për të Drejtat e Fëmijës (2021–2024) dhe vazhdimësisë së saj, që vendos digjitalizimin e shërbimeve për fëmijët si prioritet horizontal;
- Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) të BE-së 2016/679, veçanërisht në lidhje me trajtimin e veçantë të të dhënave personale të fëmijëve dhe parimin e *privacy by design*;
- Direktivës 2011/93/BE për luftimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë;
- Kapitullit 19 të *acquis-it* për Politikën Sociale dhe Punësimin, veçanërisht pjesa që ka të bëjë me shërbimet sociale dhe mbrojtjen e të miturve;
- Kapitullit 23 të *acquis-it* për Gjyqësorin dhe të Drejtat Themelore, në pjesën që mbulon mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;
- Kornizës strategjike të BE-së për ndërveprueshmërinë (*European Interoperability Framework*), që orienton dizajnin e bazave të të dhënave publike në vendet anëtare dhe kandidate.

Vlen të theksohet se menaxhimi i integruar dhe i digjitalizuar i rasteve të kujdesit alternativ përbën një standard të konsoliduar në praktikën e shumicës së vendeve anëtare të BE-së, dhe Republika e Shqipërisë përmes këtij projektvendimi përparon dukshëm drejt arritjes së këtij standardi.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi përcakton rregullat për organizimin, funksionimin, administrimin dhe aksesin në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje dhe është strukturuar në trembëdhjetë nene me përmbajtjen e mëposhtme:

### *Neni 1 — Objekti dhe qëllimi*

Projektvendimi përcakton kuadrin rregullator të Regjistrit Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje, duke specifikuar rregullat për organizimin, funksionimin, administrimin dhe aksesin në regjistër, si dhe për përpunimin, mbrojtjen dhe përdorimin e të dhënave që ai përmban.

Regjistri synon: (a) garantimin e një sistemi të unifikuar për identifikimin, referimin, menaxhimin dhe monitorimin e rasteve të fëmijëve në kujdes alternativ në familje; (b) mbështetjen e vendimmarrjes në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës; (c) sigurimin e gjurmueshmërisë së çdo mase të marrë për kujdesin alternativ; dhe (ç) përmirësimin e planifikimit dhe monitorimit të politikave dhe shërbimeve.

### *Neni 2 — Organizimi institucional*

Projektvendimi parashikon se Regjistri organizohet si pjesë përbërëse e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, duke siguruar koherencë me arkitekturën më të gjerë digjitale të shërbimeve sociale. Baza e të dhënave administrohet dhe përditësohet nga Shërbimi Social Shtetëror, si institucioni administrues, dhe aksesohet nga të gjitha njësitë e qeverisjes vendore në nivel bashkie dhe qarku. Përditësimi dhe hedhja e të dhënave në nivel vendor kryhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Administrimi teknik i infrastrukturës kryhet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### *Neni 3 — Struktura e regjistrit*

Neni përcakton funksionet kryesore të regjistrit dhe strukturën e tij modulare. Funksionet kryesore përfshijnë: ndërtimin dhe funksionimin e mekanizmit të integruar të menaxhimit të rastit; identifikimin, referimin dhe këshillimin e rasteve; lehtësimin e komunikimit me regjistra të tjerë elektronikë; dhe unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave.

Regjistri përbëhet nga module të integruara që përfshijnë: të dhëna për referimin e fëmijës dhe për familjet kujdestare, vullnetare dhe profesionale; të dhëna për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ; të dhëna për llojin, kohëzgjatjen dhe statusin e kujdesit; vendime administrative dhe gjyqësore; planin individual të kujdesit dhe/ose mbrojtjes; raportet e monitorimit dhe inspektimit; të dhëna për mbështetjen financiare; dhe historikun e plotë të rastit.

Çdo përdorues pajiset me kredenciale individuale (emër përdoruesi, fjalëkalim) dhe me manualin për përdorimin e sistemit, të miratuar nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe institucioni përgjegjës për administrimin teknik.

### *Neni 4 — Hedhja dhe përditësimi i të dhënave*

Neni parashikon afatet dhe procedurat e detyrueshme për hedhjen dhe përditësimin e të dhënave. Të dhënat hidhen dhe përditësohen në kohë reale ose brenda afateve të përcaktuara nga aktet nënligjore, dhe në çdo rast jo më vonë se brenda 7 ditëve pune nga miratimi i tyre.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmes strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës dhe shërbimet shoqërore, janë përgjegjëse për saktësinë, plotësinë, përditësimin dhe integritetin e të dhënave të regjistruara.

Përditësimi është i detyrueshëm pas çdo: (a) vendimi për vendosjen, ndryshimin ose përfundimin e kujdesit alternativ; (b) procesi monitorimi ose vlerësimi; (c) ndryshimi në statusin e fëmijës ose familjes kujdestare; (ç) vendimi për përfitime financiare; ose (d) zhvillimi tjetër me rëndësi për ecurinë e rastit.

### *Neni 5 — Ndërlidhja me sisteme të tjera*

Neni rregullon ndërlidhjen e Regjistrit me bazat e tjera të të dhënave shtetërore dhe sistemet elektronike në fuqi, përfshirë portalin e-Albania, Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC), Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), Regjistri Qendror i Llogarive Bankare (RQLLB) i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), Sistemi elektronik për

menaxhimin e kontributeve (CMIS), Regjistri Tregtar/eRegister i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe sisteme të tjera sipas nevojës. Ndërlidhja realizohet me qëllim shmangien e dyfishimit të të dhënave, garantimin e saktësisë dhe integritetit të të dhënave, dhe rritjen e efikasitetit të proceseve administrative dhe të menaxhimit të rasteve. Rregullat e ndërveprimit zbatohen sipas modelit të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi për mënyrën e krijimit, administrimit dhe ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore.

#### *Neni 6 — Përgjegjësit në proceset e punës*

Neni përcakton rolet e qarta institucionale për të gjithë aktorët e përfshirë. Përgjegjës për proceset e punës janë: (a) Ministria përgjegjëse për çështjet sociale; (b) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror; (c) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF); (ç) Drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror; (d) Drejtoritë e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki; (dh) Njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve në nivel vendor; (e) Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve; (ë) Institucionet e përkujdesjes shoqërore; dhe (f) Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror.

Neni gjithashtu përcakton dhënësit e informacionit (familjet aplikante dhe të miratuara, prindërit biologjikë, fëmijët, punonjësit socialë dhe menaxherët e rastit) dhe përgjegjësitë specifike të Shërbimit Social Shtetëror, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe njërive të vetëqeverisjes vendore.

#### *Neni 7 — Përmbajtja e Regjistrit*

Neni ndan të dhënat e regjistrit në parësore dhe dytësore.

Të dhënat parësore administrohen nga njësitë e qeverisjes vendore përmes strukturave përgjegjëse dhe përfshijnë: të dhëna për rastet e referuara; përfituesit e shërbimit; verifikimin elektronik të rastit; dosjen elektronike (me dokumentacionin përkatës, përfshirë dokumente të skanuara nga formati fizik); të dhëna mbi vendimmarrjen administrative dhe gjyqësore; planin individual të kujdesit; dhe të dhëna mbi monitorimin dhe ecurinë e rastit.

Të dhënat dytësore sigurohen përmes ndërveprimit me baza të tjera shtetërore dhe përfshijnë: të dhëna nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (NID, emër, mbiemër, atësi, gjini, datëlindje, vendbanim); të dhëna nga sistemi i Regjistrit Tregtar/eRegister i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB); dhe të dhëna nga sisteme të tjera shtetërore sipas nevojës.

#### *Neni 8 — Nivelet e aksesit*

Neni përcakton nivele diferenciale aksesit për përdoruesit e regjistrit, sipas rolit institucional. Çdo veprim në sistem regjistrohet dhe është i gjurmueshëm. Nivelet kryesore përfshijnë:

- Njësitë dhe Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve: kanë të drejtë leximi, shkrimi, vlerësimi dhe modifikimi për raste dhe planet individuale të kujdesit në juridiksionin e tyre;
- Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror: kanë të drejtë leximi dhe vlerësimi, si dhe gjenerimi të listave dhe raporteve periodike;

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror: ka të drejtë leximi dhe analizimi të të dhënave në nivel kombëtar;
- Ofruesit e shërbimit të kujdesit alternativ: kanë akses për rastet nën përgjegjësinë e tyre;
- Inspektorët përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror: kanë të drejtë leximi dhe gjenerimi për qëllime inspektimi;
- Ministria përgjegjëse për çështjet sociale: ka të drejtë leximi dhe analizimi për hartim politikash;
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës: ka rol monitorues për Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve gjatë zbatimit të procedurës së procesit të kujdestarisë familjare.

#### *Neni 9 — Mbrojtja e të dhënave personale*

Të dhënat personale në Regjistrë përpunohen vetëm për qëllime të përcaktuara ligjërish, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Institucionet përgjegjëse marrin masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë, konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave, si dhe për mbrojtjen e tyre nga aksesit i paautorizuar, humbja apo dëmtimi.

Përdoruesit e autorizuar janë të detyruar të respektojnë konfidencialitetin dhe të mos përdorin ose shpërndajnë të dhënat për qëllime të tjera. Përpunimi, shkëmbimi dhe publikimi i të dhënave realizohen duke garantuar në çdo rast interesin më të lartë të fëmijës.

Çdo shkelje e detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave personale sjell përgjegjësi administrative, civile dhe/ose penale, sipas legjislacionit në fuqi.

#### *Neni 10 — Raportimi*

Shërbimi Social Shtetëror harton raporte periodike statistikore dhe analitike mbi bazën e të dhënave të regjistrit, në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar. Të dhënat përdoren për: planifikimin dhe hartimin e politikave; planifikimin buxhetor dhe shpërndarjen e burimeve; monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve; analizën e ecurisë së rasteve; mbështetjen e proceseve të deinstitutionalizimit dhe riintegritimit familjar; dhe identifikimin e nevojave për zhvillim të shërbimeve.

Të dhënat e publikuara janë të agreguara dhe nuk përmbajnë të dhëna personale identifikuese, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### *Neni 11 — Kontrolli*

Funksionimi i Regjistrit i nënshtrohet auditimit periodik, në përputhje me legjislacionin për bazat e të dhënave shtetërore. Kontrolli përfshin verifikimin e saktësisë dhe përditësimin të të dhënave, verifikimin e përputhshmërisë së përdorimit me legjislacionin, kontrollin e respektimit të niveleve të aksesit dhe identifikimin e mangësive. Kontrolli kryhet nga strukturat përgjegjëse të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe nga struktura të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi.

Në rast konstatimi të mospërputhjeve apo shkeljeve, parashikohen masa korigjuese, kufizim ose pezullim i aksesit, njoftim i autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe masa disiplinore ose administrative sipas legjislacionit në fuqi.

#### *Neni 12 — Dispozita të fundit*

Neni parashikon se zbatimi i vendimit u ngarkohet ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, Shërbimit Social Shtetëror, Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, për administrimin teknik të sistemit, njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të tjera të përfshira në sistem. Përdorimi i Regjistrit Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje do të rregullohet përmes manualit të përdorimit, ku përcaktohen nivelet e aksesit, procedurat e operimit dhe përgjegjësitë institucionale. Regjistri do të vihet në përdorim pas zhvillimit të modulit përkatës në sistemin elektronik të shërbimeve të kujdesit shoqëror, ndërsa personat përgjegjës do të trajnohen nga Shërbimi Social Shtetëror për hedhjen e të dhënave dhe përpunimin e raporteve. Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me bashkitë, do të administrojë dhe përditësojë të dhënat, ndërsa Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit do të garantojë administrimin teknik të infrastrukturës hardware dhe software. Institucionet përdoruese janë të detyruara të hedhin dhe përditësojnë të dhënat në afat, ndërsa shkëmbimi i të dhënave me sisteme të tjera shtetërore do të kryhet në përputhje me legjislacionin për ndërveprimin e sistemeve dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

#### *Neni 13 – Hyrja në fuqi*

Neni parashikon se vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe vënies në funksionim të Regjistrit Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, për koordinimin politik, monitorimin e zbatimit dhe miratimin e manualit të përdorimit;
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), për monitorimin e Programit të Mbrojtjes së Fëmijës dhe analizat tematike;
- Shërbimi Social Shtetëror, si institucioni administrues i regjistrit, përgjegjës për konsolidimin e të dhënave kombëtare, raportimin statistikor dhe monitorimin e funksionimit të regjistrit;
- Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për monitorimin dhe mbështetjen në nivel rajonal;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë), përmes drejtorive të shërbimeve të kujdesit shoqëror, njësisë të vlerësimit të nevojave dhe njësisë për mbrojtjen e fëmijëve, për hedhjen dhe përditësimin e të dhënave parësore;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për administrimin teknik të infrastrukturës hardware dhe software;

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për organizimin, funksionimin dhe aksesin në regjistrin elektronik për kujdesin alternativ në familje"

- Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror, për kontrollin dhe inspektimin e funksionimit të sistemit;
- Institucionet e tjera publike që administrojnë baza të tjera të dhënash shtetërore, për sigurimin e shkëmbimit të të dhënave sipas legjislacionit për ndërveprimin e sistemeve.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është përgatitur nga drejtoria përgjegjëse për politikën e kujdesit shoqëror në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 92/2025 "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë".

Ky projektvendim dërgohet për mendime institucioneve të mëposhtme: Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektvendimi parashikon efekte financiare të kufizuara në buxhetin e shtetit, që mbulohen kryesisht nga buxhetet ekzistuese të institucioneve përgjegjëse.

Regjistri Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje organizohet si pjesë e sistemit elektronik të shërbimeve sociale. Për krijimin e një moduli të posaçëm të përkujdesjes alternative në regjistrin elektronik të shërbimeve sociale është parashikuar një kosto prej 1 milionë lekësh gjatë vitit 2026, e cila do të përballohet nga programi i mbrojtjes sociale i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe është i përfshirë në kontratën e mirëmbajtjes së sistemit, duke mos çuar në kosto shtesë.

### **PROPOZUESI**

**MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**

